

STATUT I SHOQËRISË
"S.P." shpk.

Ky Statut do të konsiderohet se inkorporon dhe/ose përfshin Aktin e Themelimit të Shoqërisë organizimi dhe funksionimi i të cilës rregullohet këtu.

sot, më 20/06/2023, unë:

1) Adrian Bardhi, atësia Nikolla, amësia Jolanda, shtetas Shqiptar, lindur në Durrës dhe banues në Durrës, me adresë Lagja Nr.14 Shkozë - Durrës, lindur më 24/08/1970, gjendja civile "Martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim ID nr. 034895310 dhe nr. personal H00824167H,

në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe me legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, vendosa të miratoj këtë Statut si vijon:

Në këtë statut

- "Ligji" është Ligji 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", i ndryshuar; - "Statuti" është ky Statut i Shoqërisë;

Kreu I Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, më 20/06/2023, unë, themeluesi i mësipërm, themeloj shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar me emrin dhe emërtimin tregtar "S.P." shpk.

Neni 2

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm: Implementimi dhe menaxhimi i projektit gjenerues të energjisë elektrike, fotovoltaike dhe veprave ndihmëse. Prodhim i energjise elektrike nga burimet e rinovueshme, Ndërtimi i objekteve hidroteknike, fotovoltaike, etj, të cilat bëjnë të mundur shfrytëzimin e energjisë që gjenden në natyrë dhe që janë të rinovueshme. Shitja e energjisë elektrike klientëve dhe blerja e energjisë elektrike nga operatorë të ndryshëm privat apo shtetëror brenda dhe jashtë vendit. Transmetimi i energjisë elektrike në sistemin e tensionit të lartë, funksion i cili përfshin transmetimin ose interkonjeksionin ndërkombëtar. Përdorimin e sistemeve të linjave, strukturave mbështetëse dhe pajisjesh transformuese për transmetimin e energjisë elektrike. Shpërndarjen, transportin e energjisë elektrike në sistemet shpërndarëse të tensionit të mesëm dhe të ulët, duke patur parasysh shpërndarjen deri tek konsumatori i fundit. Shoqëria ka për objekt kryerjen e çdo veprimtarie të lejuar nga ligji dhe /ose pjesëmarrjen në çdo veprimtari apo aktivitet të ligjshëm që mund të kryejë një shoqëri në bazë të legjislacionit shqiptar. Çdo aktivitet tjetër që lidhet në mënyrë direkt dhe indirekt dhe që i shërben përmbushjes së aktiviteteve si më lart.



Në funksion të qëllimeve të mësipërme Shoqëria mund të hyjë në tregje dhe operacione të ndryshme, të zotërojë pasuri të luajtshme e të paluajtshme dhe/ose pjesëmarrje në shoqëri të tjera tregtare.

Neni 3 Kohëzgjatja

•Kohëzgjatja e shoqërise do te jetë e pacaktuar dhe/ose e pakufizuar.

Neni 4 Selia

Selia e shoqërise ndodhet në adresën: Lagja Nr.14, Nr.Pasurie 5/104, Zone Kadastrale 8516, Shkozet - Durrës.

Me vendim të Administratorit, Shoqëria mund të çelë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

Kreu II Kapitali

Neni 5 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është ALL 100.000,00 (njëqind mijë lekë). Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues Adrian Bardhi: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme ALL 100.000,00 përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve është në para dhe do të shlyhet prej tyre menjëherë me themelimin e shoqërisë. Secili ortak do të ketë një numër proporcional votash me vlerën nominale të kuotës së tij.

Neni 6 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve dhe në shoqëritë kontrolluese dhe/ose të grupit të caktuara me vendimin e Asamblese. Pjesët e kapitalit mund të kalohen te të tretët vetëm me miratimin e Asamblese së Përgjithshme, që jepet nëpërmjet një vendimi të marë me unanimitet. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU 111

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) shpërndarjen e fitimeve vjetore;
- j) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblesë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e Thirrjes e Mbledhjes së Asamblesë se Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mbledhet në rastet e përcaktuara nga ligjet e aplikueshme ose nga ky Statut dhe sa herë që është e nevojshme për të mbrojtur interesat e Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme mbledhet të paktën një herë në vit.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve do të thirret nga Administratorët dhe, kur është e zbatueshme, nga Ortakët.

Njoftimi për thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme mund të dërgohet me shkrim apo e-mail në adresat që secili Ortak do t'i njoftojë me shkrim Shoqërisë me postë të regjistruar. Njoftimi do të konsiderohet se i është dorëzuar Shoqërisë me kalimin e ditës së 7-te pas dërgimit.

Njoftimi për thirrjen e Asamblesë duhet të përcaktojë qartë emrin e Shoqërisë, selinë, datën, kohën dhe vendin e mbledhjes, një përshkrim të hollësishëm të procedurës që duhet të ndiqet nga Ortakët për pjesëmarrjen dhe votimin, informacion mbi vendin e mënyrën e marrjes së dokumenteve dhe projektvendimeve që duhet tu vihen në dispozicion të gjithë Ortakëve, po ashtu edhe rendin e ditës, dhe duhet t' u njoftohet Ortakëve të paktën 7 (shtatë) ditë para mbledhjes. Rendi i ditës i njoftuar si më sipër duhet të përmbajë edhe vendimet e propozuara për çdo çështje. Nëse Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve duhet të vendosë për ndryshime të Statutit, teksti përkatës duhet të njoftohet së bashku me rendin e ditës. Ortakët mund të marrin pjesë në mbledhjet e asamblesë se përgjithshme nëpërmjet mjeteve të ndryshme të komunikimit, përfshirë mjetet e komunikimit elektronik, që garantojnë identifikimin e ortakëve. Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to: a) transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale; b) komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehen për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjetër; c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje. Përdorimi i mjeteve elektronike, për t'u mundësuar ortakëve të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar identifikimin e ortakëve dhe sigurinë e komunikimeve elektronike, deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve.

Një Ortak mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë i ndryshëm nga Administratorët, duke paraqitur dokumentin përkatës autorizues. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Të gjitha vendimet e Asamblesë duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e një kopjeje të tij.

Neni 10 Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me apo pa mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11 Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tre të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si: përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë; emërimin e administratorëve; emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; përcaktimin e shpërblimeve; mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedin e shoqërisë.

Neni 12 Përgjashtimi nga e drejta e votës

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për: vlerësimin e veprimtarisë së tij; shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij; ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria; dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13
Administrimi

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë rinovimi. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë për një mandat 5 (pesë) vjeçar emërimi:

- Adrian Bardhi, shtetas shqiptar, i ditëlindjes 24.08.1970, lindur në Durrës e banues në Durrës, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 034895310 dhe nr. personal H00824167H, pa kufizime në kompetencat e administrimit.

Neni 14
Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se

5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.



-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15

Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të

ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare", administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimitarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) Të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim a mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave I e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjet ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare, kryen veprimet e mëposhtme: u kthen ortakeve kontributet; u paguan

ortakëve interesa apo dividendë; u shpërndan aktivet shoqërise; lejon qe shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi pagueuse per të shlyer detyrimet; jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e démit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit. Paditësit kanë të drejte te ndjekin ne rrugë ligjore shlyerjen e plotë te démit i është shkaktuar shoqërise, perfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nese është e nevojshme. Asnje vendim i asamblese nuk mund te ndalojë ngritjen e kerkesi padise kundër administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

Kreu IV Viti financiar-ekspertet

Neni 16 Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17 Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqërise, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

Kreu V Prishja — Riorganizimi i Shoqërisë

Neni 18 Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërise mund të bëhet në çdo kohë: kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj; me vendim të Asamblesë së Ortakëve; me hapjen e procedurave të falimentimit; në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit 9723/2007; me vendim të gjykatës.

Ne këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesen shtesë "Shoqëri ne likuidim e sipër".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me perjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit që janë emëruar nga Ortakët.

Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t' i drejtohet gjykates, për të caktuar një likuidues.

Neni 19

Riorganizmi i shoqërisë, bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 20

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 21

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Ky akt, u lexua, u kuptua dhe u nënshkrua nga ortakët themelues si vijon:

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"S.P." shpk.

Adrian Bardhi

